



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHITJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC


Raporti nga monitorimi nr. 16/2023

-

KUVENDI NËN THJERRËZ: RAPORT NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVEND (JANAR – QERSHOR 2023)

AUTORË: VLORA REÇICA, ALEKSANDRA JOVEVSKA GJORGJEVIQ DHE NIKOLLA DONE

GUSHT 2023



IMPLEMENTUAR NGA:



Ky publikim është përgatitur në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PMP) nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS). Programi financohet nga Qeveria e Zvicrës, zbatuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci Societas Civilis - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Qeverisë së Zvicrës

PËRMBAJTJA

I.	METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	5
II.	HYRJE	7
III.	REZYME	9
IV.	CILËSIA E DEBATIT	13
	Vlerësimi i cilësisë së debatit	13
	Lloji i diskutimeve	14
	Shkalla e argumentimit	19
	Përgjegjësi	23
	Fuqia e argumentit më të mirë	25
	Raportet e trupave të pavarura dhe rregullatore	27
V.	RESPEKT, NDËRPRERJE DHE KUFIZIME	31
	Raporti ndaj argumenteve dhe personalitetit të deputetëve nga një parti tjetër	31
	Qëndrimi ndaj argumenteve dhe personalitetit sipas përkatësisë politike të deputetëve	34
	Raporti ndaj argumenteve dhe personalitetit sipas llojit të pjesëmarrësve në diskutim	36
VI.	GRUPET E MARGJINALIZUARA NË KUVEND	41
VII.	DEMOGRAFIA E FOLËSVE	45
IX.	REKOMANDIME	49
X.	SHTOJCA 1 - INDEKSI I CILËSISË SË DEBATIT	57

IMPRESUM

Titulli: Kuvendi nën thjerrëz: Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend (janar – qershor 2023): Raporti nga monitorimi nr. 16/2023

Titulli i originalit: Поглед на Собрание: Извештај од набљудувањето на квалитетот на дебатата во Собранието

(јануари - јуни 2022): Извештај од набљудување бр. 16/2023

Botues: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Autorë: Vlora Reçica, Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq dhe Nikolla Donev

Redaktues: Marko Troshanovski

Përktheu nga gjuha maqedonase: Vjosa Taipi

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Shtypshkronja: Rojal Art

Vendi dhe viti i botimit

Shkup, 2023

Tirazhi

20 kopje

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.537.4:005.584.1(497.7)"2023"(047.31)

REÇICA, Vlora

Kuvendi nën thjerrëz : raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend : (janar – qershor 2023) : raporti nga monitorimi nr. 16/2023 / autorë Vlora Reçica, Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq dhe Nikolla Donev ; [përktheu nga gjuha maqedonase Vjosa Taipi]. - Shkup : Instituti për Demokraci "Societas Civilis", 2023. - 54, [2] стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Поглед на Собрание : извештај од набљудувањето на квалитетот на дебатата во Собранието : (јануари - јуни 2023) : извештај од набљудување бр. 16/2023. - Фусноти кон текстот. - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-266-041-7

1. Jovevska Gjorgjeviq, Aleksandra [автор] 2. Donev, Nikolla [автор]
а) Собрание -- Квалитет на дебата -- Мониторинг -- Македонија -- 2023
-- Истражувања

COBISS.MK-ID 61312261

I. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Cilësia e debatit në Kuvend është analizuar me përdorimin e «Indeksit të Cilësisë së Debatit». Indeksi është instrument që lejon secili akt individual i fjalës në seancën e monitoruar të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore:

- shkalla e argumentimit të fjalimit (sa argumente ka në secilin diskutim);
- shkalla e respektit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumentet e tyre;
- hapja për pranimin e argumenteve të huaja dhe ndryshimi i qëndrimeve individuale për shkak të argumenteve më cilësore të paraqitura në debat;
- mundësi që deputetët të shprehin pa pengesa pikëpamjet e tyre.

Në Raportet gjysmë-vjetore mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend gjithashtu përfshihet edhe **vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë së debatit sipas Indeksit të cilësisë së debatit - Discourse Quality Index (DQI)**. Ky indeks jep notën mesatare prej 1 deri në 10 për cilësinë e debatit në Kuvend.

Me këtë indeks përfshihen shkalla e arsytimit (20% të notës), përfshirja e arsytimit (5%), përgjegjësia (20%), forca e argumentit më të mirë (20%), raporti ndaj pjesëmarrësve të partisë tjetër (10%), raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve nga parti tjetër (10%), raporti ndaj pjesëmarrësve të jashtëm (2,5%), raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm (2,5%), ndërprerje (5%) dhe kufizim (5%) si indikatorë.

Një (1), si nota më e ulët do të thotë se deputetët nuk përdorin asnjë argument gjatë fjalimeve të tyre, nuk u referohen parimeve të caktuara, i shtrembërojnë argumentet, nuk ndryshojnë pozicionin e tyre dhe nuk pranojnë argumente, nuk kanë referencë ndaj argumenteve të tjerëve ose kanë ndryshim të qëndrimit, por jo për shkak të argumenteve të tjetrit. Nota një (1) gjithashtu do të thotë që deputetët tregojnë mosrespektim ndaj pjesëmarrësve të tjerë dhe argumenteve të tyre (deputetë ose pjesëmarrës të jashtëm), se ka ndërprerje të diskutimit dhe se në një moment ka pasur ndërprerje fizike të folësve. Nga ana tjetër, nota dhjetë (10), që do të thotë se cilësia e debatit është e shkëlqyeshme, do të thotë që deputetët përdorin më shumë se dy argumente, ose të paktën një argument gjatë fjalimeve të tyre, i referohen parimeve të caktuara, adresojnë argumentet në përputhje me rrethanat, ka ndryshim të qëndrimit për shkak të argumenteve më të mira, tregojnë respekt për personin dhe argumentet e pjesëmarrësve të tjerë në diskutim (deputetë ose pjesëmarrës të jashtëm), nuk ka ndërprerje të diskutimit dhe nuk ka asnjë kufizim të së drejtës për fjalë.

Më shumë detaje rreth metodologjisë dhe vlerësimit, në Shtojcën 1.

II. HYRJJE

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka pushtet legjislativ dhe në këtë mandat përbëhet nga 120 deputetë. Deputetët zgjidhen me zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave zgjedhore proporcionale për mandat prej katër vjet. Duke vazhduar praktikën joformale, në tetor 2019, Kryeministri i qeverisë së atëhershme të LSDM-së, Zoran Zaev paralajmëroi për takim të liderëve në të cilin do të propozoi zgjedhje të parakohshme parlamentare,¹ të pestat me radhë për vendin. Zgjedhjet erdhën pasi vendi nuk ishte në gjendje të hapte negociatat me Bashkimin Evropian (BE) për shkak të vetos franceze dhe besimit të lëkundur në qeverinë e LSDM-së, platforma e së cilës bazohej kryesisht në rrugën e pandërprerë të vendit drejt BE-së. Në shkurt të vitit 2020, në seancën e 137-të të Kuvendit, me 113 vota pro dhe asnjë kundër ose të përmbytur, unanimisht u miratua vendimi për shpërndarjen e tij, ndërsa të nesërmen, më 17 shkurt, Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, i shpalli zgjedhjet² më 12 prill³. Pavarësisht nga planet për zgjedhjet parlamentare të mbahen në prill, për shkak të përqesimit të situatës me Kovid 19 pandeminë, ato u shtynë dhe u mbajtën përfundimisht më 15 korrik 2020.

Në këto zgjedhje, LSDM dhe koalicioni «Mundemi» - fitoi 46 deputetë, VMRO-DPMNE-ja dhe koalicioni «Ripërtëritje për Maqedoninë», fituan 44 deputetë, ndërsa Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) fitoi 15 deputetë. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa fitoi 12 deputetë, E Majta fitoi 2 deputetë, ndërsa Partia Demokratike e Shqiptarëve fitoi 1 deputet. Koalicion qeveritar u formua midis LSDM-së dhe koalicionit «Mundemi» dhe BDI-së dhe PDSH-së, pas negociatave disa javore midis partive politike. Me këtë koalicion, qeveria siguroi shumicën në Kuvend me 62 deputetë, ndërsa opozitës iu bashkuan VMRO-DPMNE-ja dhe Koalicioni «Ripërtëritje për Maqedoninë», Koalicioni Aleanca e Shqiptarëve dhe Alternativa dhe E Majta. Shumica në Kuvend do të ndryshojë në nëntor 2021. Pas dorëheqjes së paralajmëruar të Zoran Zaev nga pozita e liderit të LSDM-së dhe kryeministrit, Lëvizja Besa iu bashkua opozitës në përpjekje për te votuar mosbesim qeverisë së udhëhequr nga LSDM-ja. Iniciativa për votëbesim rezultoi e pasuksesshme, për shkak të ndryshimit të qëndrimit të njërit prej deputetëve të Lëvizjes Besa. Pas disa javë negociata, LSDM-ja do të arrijë të formojë koalicion me Alternativën opozitare, kështu që nga janar 2022, Kuvendi vazhdoi të funksionojë me një shumicë të re të formuar nga LSDM-ja dhe koalicioni, BDI, PDSH dhe Alternativa, me gjithsej 64 deputetë. Në shkurt 2023, do të votohet një riorganizim i ri i Qeverisë, me këtë do të ndryshohet përbërja e shumicës në Kuvend. Nga Qeveria do të dalë Alternativa, ndërsa do të hyjnë tre ministra të ri nga Aleanca për Shqiptarët. Gjithashtu, nga përbërja origjinale e Kuvendit, gjithsej 16 deputetë e kthyen mandatin për poste në diplomaci ose në pushtet ekzekutiv.

¹ "Zaev: Shkojmë drejt zgjedhjeve të parakohshme", Deutsche Welle, 19 tetor 2019. Qasur më: <<https://p.dw.com/p/3RYux>>(vizita e fundit: 10 mars 2020)

² Aktvendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktvendimi është marrë nga ueb faja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ). Qasur në: <https://www.sec.mk/parlamentarni-izbori-2020/?thumbnail_id=6946> (vizita e fundit: 9 mars 2020)

³ Pankovski, M. dhe të tjerët (2020) Doracak për Zgjedhjet Parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020: Botimi i dytë i plotësuar. Fondacioni Konrad Adenauer, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Në periudhën janar-qershor 2023, Kuvendi në përgjithësi ka qenë aktiv me seanca. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi kryesisht diskutoi për rikonstruimin e Qeverisë, Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për ndërtim, dhe mbajti gjashtë seanca për pyetje të deputetëve dhe një debat mbikëqyrës për zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit për personat e paregjistruar në librin amzë të të lindurve.

Në mes të periudhave të raporteve gjashtëmujore për cilësinë e debatit, IDSCS ka publikuar disa analiza të shkurtra për debati në Kuvend bazuar në periudhat e mëparshme të monitorimit të cilësisë së debatit dhe këto janë në dispozicion në këtë [link](#).⁴ Më shumë informacion për nivelin e cilësisë së debatit në Kuvend për periudhën korrik - dhjetor 2021 mund të gjeni në linkun e mëposhtëm **“Kuvendi nën thjerrëz: Raport për monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend (korrik – dhjetor 2022)”**.⁵

Në periudhën janar - qershor 2023, monitorimi u përqendrua në diskutimet në lidhje me pikat e rendit të ditës së Kuvendit në fushat e sundimit të së drejtës, të drejtat e njeriut dhe demokracia. Në këtë drejtim, Instituti për Demokraci monitoroi ato trupa pune të Kuvendit dhe seanca plenare në fushëveprimin e të cilave bëjnë pjesë fushat e lartpërmendura. **Para Ju është Raporti mbi cilësinë e debatit në Kuvend, i cili i referohet periudhës nga janari deri në qershor 2023.**

⁴ Analiza të shkurtra mund të gjenden këtu: <https://idscs.org.mk/en/category/all-publications/>

⁵ Raporti gjysmë vjetor “Vështrim mbi Kuvendin: Raporti mbi cilësinë e debatit në Kuvend (janar – qershor 2022)” mund të gjendet këtu: <https://idscs.org.mk/en/2022/08/24/parliament-view-monitoring-report-of-quality-debate-in-parliament-January-June-2022/>

III. REZYME

Raporti tregon nivel relativisht të ulët të cilësisë së debatit në Kuvend në këtë mandat dhe konfirmon përfundimin se ka vend për përmirësim të konsiderueshëm. **Në shkallën nga 1 - më e ulëta në 10 - më e larta, nota mesatare për cilësinë e debatit në Kuvend në gjysmën e parë të vitit 2023 është 5,5.**

Deputetët e opozitës ishin më aktivë me pjesëmarrjen në diskutime, duke marrë pjesë në 76% të diskutimeve të monitoruara, ndërsa deputetët e pushtetit morën pjesë në 24%. Deputetët që qëndruan më gjatë në foltoren e Kuvendit janë: Dajanço Eftimov, Zdravko Trajanov dhe Beti Stamenkoska Trajkoska. Në mesin e dhjetë deputetëve që qëndruan më gjatë në foltore gjatë kësaj periudhe monitorimi, ishin pesë deputete të opozitës, Beti Stamenkoska Trajkoska, Gordana Siljanovska Davkova, Bllagica Llasovska, Lidija Petkoska dhe Eli Panova. **Pjesëmarrja e grave në diskutim është në nivel prej 43%, dhe mbetet në nivel relativisht të lartë, si dhe përfaqëson pjesëmarrjen më të lartë të grave në diskutim krahasuar me mandatet e monitoruara më parë.**

Raporti shënon nivel të ngjashëm të ndërveprimit dhe shkëmbimit të qëndrimeve midis pjesëmarrësve në diskutim me periudhën e paraprake të monitorimit (korrik - dhjetor 2022). **Gjatë periudhës së vëzhgimit u mbajtën të gjitha gjashtë seancat për pyetje të deputetëve.**

Në 49% të diskutimeve të analizuara,⁶ pjesëmarrësit nuk kishin argumente, ndërsa në 44% të diskutimeve të analizuara kishin argumentim të dobët, përkatësisht folësit ofruan arsyetim të pozicioneve të tyre, që nuk është i mjaftueshëm për tu konsideruar si një argument i plotë. Niveli i argumentimit është përkeqësuar pak në krahasim me periudhën e mëparshme të vëzhgimit korrik – dhjetor 2022. Vetëm 8 folës përdorën 2 argumente, ndërsa në diskutimet e monitoruara folësit përdorën më shumë se dy argumente për të mbështetur qëndrimin e tyre në vetëm dy raste ose vetëm në 0,1% të fjalimeve të monitoruara.

Në lidhje me atë se si deputetët i përgjigjen argumenteve të bëra nga folës të tjerë, monitorimi vëren se vetëm në 5% të fjalimeve të tyre, deputetët i kanë adresuar në mënyrë përkatëse argumentet, përkatësisht deputeti / deputetja drejtpërdrejtë i është përgjigjur argumenteve të cilat paraprakisht i ka adresuar pjesëmarrës tjetër në diskutim. Në 37% të rasteve, nuk ishin adresuar argumente ose pyetje nga deputetë të tjerë, që sugjerojnë në përgjithësi nivel të ulët të diskutimit. Nuk vërehen ndryshime të konsiderueshme në krahasim me periudhën e mëparshme të vëzhgimit (korrik - dhjetor 2022).

Në këtë periudhë raportuese, **nuk është vërejtur ndryshim i pozicionit në diskutimet e vëzhguara midis deputetëve, për shkak të argumenteve më të mira të bashkëbiseduesve ose ndonjë arsye tjetër,** e cila është në të njëjtin nivel me periudhën e fundit të vëzhgimit (korrik – dhjetor 2022).

⁶ Analiza gjithashtu përfshin pjesëmarrës të jashtëm në diskutim.

Nga janari deri në qershor të vitit 2023 është vëzhguar shqyrtimi i 16 raporteve nga trupat e pavarura dhe rregullatore të dorëzuara në Kuvend. **Tre raporte nuk u diskutuan fare në seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve gjatë kësaj periudhe raportuese. Për tre raporte diskutimi ishte mjaft i shkurtër, diskutuan dy, përkatësisht tre diskutantë në total për secilin raport. Për 10 raportet e tjera nga organet e pavarura dhe rregullatore, deputetët zhvilluan një diskutim në komision dhe seanca plenare dhe ato iu nënshtruan në një nivel të caktuar shqyrtimi.** Këtë periudhë deputetët në përgjithësi u përfshinë në diskutimin aktiv dhe shqyrtimin e një numri më të madh të raporteve, për të cilat është jashtëzakonisht e rëndësishme të shqyrtohen në Kuvend, në mënyrë që të rritet transparenca mbi punën e pushtetit ekzekutiv, me çka qytetarët do të kenë këqyrje më të madhe në punën e trupave të pavarura dhe rregullatore.

Në periudhën janar – qershor 2023, deputetët në mbi 70% të fjalimeve të tyre nuk trajtuan as argumentet e bashkëbiseduesit të një opsioni tjetër politik (71%) as personalitetin e tyre (78%). Kjo marrëdhënie ndryshon nga periudha e mëparshme e monitorimit (korrik-dhjetor 2022), kur argumentet e bashkëbiseduesve nuk u adresuan në 60% të fjalimeve, ndërsa personaliteti i tyre nuk u përmend në 46%. Përveç kësaj, mund të konkludohet se deputetët në pjesën tjetër të fjalimeve të tyre i referohen më pak karakteristikave personale të bashkëbiseduesve dhe më shumë një shqyrtimi substancial të argumenteve të tyre.

Raporti konfirmon edhe vëmendjen vazhdimisht të ulët të deputetëve për të drejtat e grupeve të marginalizuara, gjatë të gjitha periudhave të monitorimit. **Është vërejtur se deputetët në pothuajse 87,3% të diskutimeve të tyre, nuk flasin në lidhje me të drejtat e grupeve të marginalizuara, përveç nëse diskutohet specifikisht për ligj ose temë të caktuar në rendin e ditës në lidhje me të drejtat e tyre.** Megjithëse deputetët në përgjithësi rrallë u drejtohen të drejtave të grupeve të marginalizuara dhe komuniteteve, **deputetët në masë të madhe u referohen këtyre komuniteteve për dallim nga kolegët e tyre deputetë.**

IV.

CILËSIA E DEBATIT



IV. CILËSIA E DEBATIT

■ VLERËSIMI I CILËSISË SË DEBATIT

Rezultati i cilësisë së debatit për periudhën janar-qershor 2023, në shkallën nga 1 deri në 10, është 5,5 – duke treguar një përkeqësim të lehtë në cilësinë e diskutimit në krahasim me periudhën korrik-dhjetor 2023, për të cilën periudhë nota për cilësinë e debatit ishte 5,7, dhe është në të njëjtin nivel me periudhën janar-qershor 2022, kur kjo notë ishte 5,5. Me notën 5,5, diskutimi në Kuvend nuk merr notën minimale të nevojshme për t' u cilësuar si një debat i shëndetshëm, veçanërisht duke pasur parasysh notat e dobëta rreth hapjes për pranimin e argumenteve të huaja dhe ndryshimin e pikëpamjeve të tyre për shkak të argumenteve më cilësore të paraqitura në debat. Në përgjithësi, cilësia e debatit, si në periudhat e mëparshme, është e ulët, me shumë hapësirë për përmirësim.

Me notën 5.5 në përgjithësi, cilësia e debatit, si në periudhat e mëparshme, është e ulët, me shumë hapësirë për përmirësim.

**THE SCORE FOR DISCOURSE QUALITY
FOR THE PERIOD JANUARY - JUNE 2023,
ON A SCALE FROM 1 TO 10**



■ LLOJI I DISKUTIMEVE

Në këtë periudhë (janar – qershor 2023) 74% e diskutimeve të monitoruara ishin pjesë e seancave plenare, ndërsa 26% ishin diskutime të komisioneve⁷. **Janë monitoruara gjithsej 2 147 diskutime ose fjalime të deputetëve dhe pjesëmarrësve⁸ të jashtëm në debat.**

Në total, në gjysmën e parë të vitit 2023, **u mbajtën gjashtë seanca të pyetjeve të deputetëve, ndërsa nuk u vërejt asnjë seancë kushtuar debateve publike dhe diskutimeve publike.** Nga diskutimet e monitoruara, 26% iu referuan ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit, ndërsa 7% propozimeve të reja ligjore. 11% e diskutimeve kishin të bënin me raporte nga organe të pavarura ose rregullatore, 11% iu kushtuan pyetjeve të deputetëve, ndërsa 46% e diskutimeve të monitoruara kishin të bënin me akte të tjera, duke përfshirë diskutime mbi interpretimet autentike të ligjeve; analiza, raporte, informacione dhe materiale të tjera; zgjedhje, emërime dhe shkarkime të funksioneve publike dhe funksione të tjera; diskutime mbikëqyrëse; vërejtje procedurale dhe ratifikime të marrëveshjeve ndërkombëtare. Propozues në pjesën më të madhe (65%) të projektligjeve, ndryshimeve dhe shtesave në ligje si dhe akteve të tjera, del Qeveria, ndërsa për 12% të akteve propozues zyrtarë ishin deputetët, ndërsa 23% e akteve të tjera ishin raporte të paraqitura nga organe të pavarura dhe rregullatore. **Nga aktet e monitoruara, 72% u zbatuan në procedurë normale, 16% me procedurë të shkurtuar, ndërsa 12% e akteve të monitoruara në Kuvend u shqyrtuan me flamur Evropian.**

Deputetët duhet të përdorin me kujdes dhe në mënyrë minimale procedurën e shkurtuar dhe procedurën për shqyrtimin e propozim - ligjeve me flamurin Evropian.

Në periudhën janar – qershor 2023, nga aktet e monitoruara, 72% janë kryer me procedurë normale, 16% me procedurë të shkurtuar, ndërsa 12% e akteve të monitoruara në Kuvend janë shqyrtuar me flamur evropian.

⁷ Komisioni për Sistemin Politik dhe Marrëdhëniet Ndër-Bashkësive, Komisioni për Financa dhe Buxhet, Komisioni për Çështje Evropiane, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve, Komisioni për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit, Komisioni për Punë dhe Politikë Sociale, Komisioni Juridik-Ligjvënë, Komisioni për Çështje Ekonomike, Komisioni për Kulturë, Komisioni për Politikë të Jashtme, Komisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masave nga Monitorimi i Komunikimit, Komisioni për Arsimin, Shkencë dhe Sport, Komisioni për Punë dhe Politikë Sociale, Komisioni për Marrëdhëniet Ndërmjet Bashkësive dhe Këshilli Nacional për Euro-Integrime.

⁸ Si pjesëmarrës të jashtëm në diskutimin në Kuvend konsiderohen të gjithë folësit në seancat plenare dhe komisionet që nuk mbajnë statusin e deputetit, por kanë të drejtë të marrin pjesë në debatin parlamentar, siç janë Kryeministri, ministrat, përfaqësuesit e trupave rregullatore dhe agjencitë etj.

Në seancat e monitoruara, diskutim më i madhu zhvillua për “Propozimin për shkarkimin e anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut”, “Propozimin për zgjedhjen e anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut”, “Propozim -ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Marrëdhënie pune, me procedurë të shkurtuar” dhe “Propozim - ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim”, me procedurë të shkurtuar.

Në seancat e monitoruara, diskutim më i madhu zhvillua për “Propozimin për shkarkimin e anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut”, “Propozimin për zgjedhjen e anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut”, “Propozim -ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Marrëdhënie pune, me procedurë të shkurtuar” dhe “Propozim - ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim, me procedurë të shkurtuar.” Një diskutim më i gjerë u mbajt gjithashtu në seancën kushtuar pyetjeve të deputetëve.

Sipas përkatësisë politike të folësve nga monitorimi në këtë periudhë, rezulton se deputetët e pushtetit të përbërë nga LSDM dhe koalicioni, BDI, Aleanca për Shqiptarët⁹ dhe PDSH morën pjesë në 24% të diskutimeve të monitoruara, ndërsa opozita e përbërë nga VMRO-DPMNE dhe koalicioni, Koalicioni Alternativa, Lëvizja Besa dhe E Majta, morën pjesë në 76% të diskutimeve të monitoruara.¹⁰

Grafiku 1. Përkatësia politike e deputetëve (%)




⁹ Kuvendi votoi për ministrat e rinj të Aleancës për Shqiptarët më 27 shkurt 2023.

¹⁰ Përbërja e shumicës parlamentare dhe opozitës do të ndryshojë në shkurt 2023, kur do të formohet koalicioni i ri qeveritar i përbërë nga LSDM dhe koalicioni, BDI, PDSH dhe Aleanca për Shqiptarët, ndërsa opozita do të përbëhet nga VMRO-DPMNE dhe koalicioni, Alternativa, Lëvizja Besa dhe E Majta.

Në listën e dhjetë deputetëve më aktivë janë vetëm deputetë të opozitës. Deputetët që qëndruan më gjatë në foltoren parlamentare janë: Dajanço Eftimov me 709 minuta, Zdravko Trajanov me 631 minuta dhe Beti Stamenkoska Trajkoska me 451 minuta. Sipas asaj se sa herë janë paraqitur fjalë, më aktiv është deputeti Zdravko Trajanov, i cili e mori fjalë 85 herë, deputeti Dianço Eftimov dhe Bojan Stojanoski me 70 herë dhe Lidija Petkoska me 59 herë. **Në mesin e dhjetë deputetëve që qëndruan më gjatë në foltore gjatë kësaj periudhe monitorimi, ishin pesë deputete të opozitës, Beti Stamenkoska Trajkoska, Gordana Siljanovska Davkova, Bllagica Llasovska, Lidija Petkoska dhe Eli Panova.**

Grafiku 2¹¹. Cilët deputetë ishin më aktivë?




¹¹ Grafiku përshkruan se cilët deputetë ishin më aktivë nga gjithsej 1 852 diskutime ose fjalime të deputetëve në periudhën janar – qershor 2023.

Sipas llojit të diskutimeve të monitoruara në këtë periudhë, shumica e tyre janë fjalime (41%), ndërsa 35% e diskutimeve janë replika dhe 23% kundër replika dhe 2% vërejtje procedurale. Të drejtën e vërejtjes procedurale deputetët e kanë shfrytëzuar 31 herë (2%) për të shprehur pikëpamjet dhe mendimet e tyre. Nëse shikojmë grafikun 3.1, mund të shihet se pjesa më e madhe e diskutimit, përfshirë replikat dhe kundër-replikat, u përkasin deputetëve të opozitës, gjë që tregon një nivel të ulët të ndërveprimit midis deputetëve nga pushteti dhe opozita.

Ndërveprimi midis deputetëve të pushtetit dhe opozitës është në nivel të ulët.

Grafiku 3. Lloji i diskutimeve (%)




Duke iu referuar llojit të diskutimit sipas përkatësisë politike të folësve, mund të vërehet se shumica e diskutimit inicohet nga opozita, përmes fjalimeve të tyre (91%) për pikat e rendit të ditës, ndërsa shumica e replikave i përkasin pushtetit (56%). Pjesë më e madhe e kundër replikave i përkasin opozitës (94%). Opozitës i takojnë edhe pjesa më e madhe e vërejtjeve procedurale (90%).^{12 13}

¹² Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut <<https://www.sobranie.mk/content/Delovnik%20na%20RM/DelovniknaSRMPrecistentekstAvgust13.pdf>>

¹³ Rendi i debatit dhe kohëzgjatja e fjalimeve rregullohen me nenet 86 dhe 89 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në aspekte të caktuara ndikojnë në strukturën e folësve.


Grafiku 3.1 Lloji i diskutimit sipas përkatësisë politike (%)



Sipas Rregullores së Kuvendit të RMV-së, dhoma ligjvënëse është e detyruar të mbajë seancë për pyetje të deputetëve çdo të enjten e fundit të muajit.¹⁴ Në periudhën janar - qershor 2023, u mbajtën të gjitha gjashtë seancat pyetje të deputetëve. Pyetjet e deputetëve janë mjet kryesor për mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, por edhe për të kërkuar përgjegjësi prej saj. Prandaj, është thelbësore që Kuvendi të organizojë në mënyrë konsekuente seancat për pyetje deputetësh. Në seancat e mbajtura 58% e diskutimit iu kushtua pyetjeve të shtruar, ndërsa pjesa tjetër e diskutimit iu kushtua përgjigjeve të pyetjeve të deputetëve (43%) nga përfaqësuesit e Qeverisë.

Gjatë kësaj periudhe, seancat për pyetje të deputetëve janë zhvilluar rregullisht dhe siç përcaktohet në Rregullore.

Grafiku 4. Seanca për pyetjet parlamentare (%)




¹⁴ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut <<https://www.sobranie.mk/content/Delovnik%20na%20RM/DelovniknaSRMPrecistentekstAvgust13.pdf>>

■ SHKALLA E ARGUMENTIMIT

Në 49% të diskutimeve të analizuara, pjesëmarrësit nuk kishin argumente, ndërsa në 44% të diskutimeve të analizuara kishin argumentim të dobët, përkatësisht folësit ofruan arsytim të pozicioneve të tyre, që nuk është i mjaftueshëm që të konsiderohet si një argument i plotë. Niveli i argumentimit është përkeqësuar pak në krahasim me periudhën e mëparshme të vëzhgimit korrik – dhjetor 2022. Në vetëm 7% të diskutimeve të monitoruara folësit përdorën një argument për të shpjeguar pozicionin e tyre, që është niveli i njëjtë në krahasim me periudhën e mëparshme. Vetëm 8 folës përdorën 2 argumente, ndërsa në diskutimet e monitoruara folësit përdorën më shumë se dy argumente për të mbështetur qëndrimin e tyre në vetëm dy raste ose vetëm në 0,1% të fjalimeve të monitoruara.

Në 44% të diskutimeve të analizuara, pjesëmarrësit kishin argumentim të dobët, përkatësisht, folësit ofruan shpjegim të qëndrimeve të tyre që nuk është i mjaftueshëm të konsiderohet argument i plotë.

Grafiku 5. Shkalla e argumentimit të diskutimeve (%)




Nga gjithsej 2 147 fjalime të monitoruara të deputetëve dhe pjesëmarrësve të jashtëm në diskutim, 86% (1 850) i përkasin deputetëve, ndërsa 14% (297) i përkasin pjesëmarrësve të jashtëm, përkatësisht të gjithë folësit në seancat plenare dhe të komisioneve që nuk kanë statusin e deputetit, por kanë të drejtë të marrin pjesë në debatin parlamentar, si për shembull kryeministri, ministrat, përfaqësuesit e trupave rregullatore dhe agjencive, përfaqësues të organizatave civile etj. Nëse analizojmë shkallën e argumentimit sipas llojit të folësit, deputetët më shpesh nuk përdorin argumente në krahasim me pjesëmarrësit e jashtëm në diskutim.

Dallimet midis folësve gjatë kësaj periudhe janë më të konsiderueshme, megjithatë, shkalla e argumentimit është në një nivel të ulët në diskutimet e deputetëve dhe pjesëmarrësve të jashtëm.

Dallimet midis folësve gjatë kësaj periudhe janë më të konsiderueshme, megjithatë, shkalla e argumentimit është në një nivel të ulët në diskutimet e deputetëve dhe pjesëmarrësve të jashtëm.

Grafiku 5.1 Shkalla e argumentimit të diskutimeve sipas llojit të pjesëmarrësve në diskutim (%)




Nëse të dhënat analizohen sipas përkatësisë politike të deputetëve, 44% e diskutimit të bërë nga deputetët e pushtetit është argumentuar dobët, ndërsa në 53% nuk është identifikuar asnjë arsyetim në lidhje me temën e diskutimit në seancë. Në 3% të diskutimeve të shumicës parlamentare, u identifikua një argument, ndërsa dy argumente u identifikuan vetëm te një deputet. Nuk janë vërejtur aspak diskutime me më shumë argumente. Krahasuar me nivelin e argumentimit të diskutimeve në periudhën e fundit raportuese, niveli i argumentimit të pushtetit është përgjithësisht i njëjtë, me një përkeqësim të vogël.

Opozita dhe pushteti nuk dallojnë shumë në shkallën e argumentimit në fjalimet e tyre në dhomën ligjvënëse.

Në lidhje me diskutimin e deputetëve të opozitës në periudhën janar-qershor 2023, 42% karakterizohet nga argumente të dobëta, ndërsa në 53% të diskutimeve të tyre nuk përdorën argumente aspak. Krahasuar me periudhën e mëparshme, te opozita vërehet rritje e diskutimeve të paargumentuara. Në 6% të diskutimeve, deputetët e opozitës kanë përdorur një argument, ndërsa 3 deputetë/te në fjalimet e tyre kanë përdorur dy argumente.

Opozita dhe pushteti nuk dallojnë shumë në shkallën e argumentimit në fjalimet e tyre në dhomën ligjvënëse.

Grafiku 6. Shkalla e argumentimit të diskutimeve sipas përkatësisë politike (%)




Deputetët në vetëm 11% të diskutimeve të monitoruara përdorën fakte nga hulumtime, përvoja, dokumente dhe burime të tjera përkatëse si pjesë e arsytimit të tyre, duke konfirmuar kështu nivelin e përgjithshëm të ulët të argumentimit

Argumentet, sipas metodologjisë që zhvilloi Instituti për Demokraci për monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, përkufizohen si një përpjekje e arsyeshme (e arsyetuar) për të bindur publikun të pranojë një këndvështrim të caktuar për një tezë të diskutueshme, përkatësisht argumenti është shkak pse deputetët mbështesin ose sulmojnë një tezë të caktuar. Fjalim i argumentuar konsiderohet të jetë fjalimi që përmban një pohim - titulli i argumentit, një fjali me të cilën pretendon diçka; shpjegim - sqarimi dhe lidhja e pretendimit dhe thelbit të tij, përkatësisht zbërthimi dhe depërtimi në thelbin e argumentit dhe çështjes dhe provave - me atë që argumenti do të ishte vetëm një frazë e zbrazët nëse nuk ka ndonjë provë të vlefshme dhe të fortë. **Për të zbërthyer**

dhe analizuar më mirë elementët e ndryshëm të argumenteve të përdorura gjatë diskutimit në Kuvend, nga prilli 2021, me një mjet shtesë në pyetësin për monitorimin e cilësisë së debatit është përfshirë shënimi i fakteve që deputetët përdorin në fjalimet e tyre. Këto fakte mund të jenë dëshmi nga hulumtime, përvoja, dokumente dhe burime të tjera relevante, si një pjesë thelbësore e të gjithë argumentit.

Në lidhje me seancat e monitoruara të mbajtura në periudhën janar - korrik 2023, nga deputetët në 89% të diskutimeve të monitoruara, nuk janë përdorur fakte nga hulumtime, përvoja, dokumente dhe burime të tjera relevante si pjesë e arsytimit të tyre, pse mbështesin ose nuk mbështesin një akt të caktuar. Vetëm në 11% të diskutimeve të monitoruara gjatë kësaj periudhe është vërejtur përdorim i fakteve nga deputetët, gjë që konfirmon nivelin e përgjithshëm të ulët të argumentimit. Edhe pse në nivel të ulët, megjithatë vërehet një përmirësim i lehtë në diskutimet për përdorimin e qartë të burimeve në fjalimet e deputetëve.

Grafiku 7. A përdor deputeti/ deputetja fakte nga hulumtime, përvoja, dokumente dhe burime të tjera përkatëse? (%)




■ PËRGJEGJËSI

Në lidhje me atë se si deputetët i përgjigjen argumenteve të bëra nga folës të tjerë, monitorimi vëren se vetëm në 5% të fjalimeve të tyre, deputetët i kanë adresuar në mënyrë përkatëse argumentet, përkatësisht deputeti / deputetja drejtpërdrejtë i është përgjigjur argumenteve të cilat paraprakisht i ka adresuar pjesëmarrës tjetër në diskutim. Për më tepër, në 36% të diskutimit, deputetët pjesërisht iu përgjigjen argumenteve të adresuara ndërsa pjesërisht i shtrembëruan ose i injoruan ato. Në 13% të rasteve argumentet nuk u injoruan, por u shtrembëruan, ndërsa në 10% argumentet e deputetëve të tjerë u injoruan plotësisht. Në 37% të rasteve, nuk ishin adresuar argumente ose pyetje nga deputetë të tjerë, që sugjerojnë në përgjithësi nivel të ulët të diskutimit. Nuk vërehen ndryshime të konsiderueshme në krahasim me periudhën e mëparshme të vëzhgimit (korrik - dhjetor 2022).

Në vetëm 5% të fjalimeve të tyre, deputetët adresuan në mënyrë adekuate argumentet, përkatësisht deputeti iu përgjigj drejtpërdrejt argumenteve të adresuara më paraprakisht nga një pjesëmarrës tjetër në diskutim.

Grafiku 8. Përgjegjësia e deputetëve (%)




Analizuar sipas përkatësisë politike të deputetëve, rezulton se deputetët e shumicës adresuan argumentet në mënyrë përkatëse në 6% të diskutimit. Tek deputetët e opozitës, kjo u vu re në 5% të diskutimeve.

Deputetët e opozitës në 33% të diskutimit të tyre vendosën t'u përgjigjen pjesërisht argumenteve, pjesërisht t'i shtrembërojnë ose t'i injorojnë, ndërsa deputetët e shumicës këtë e bënë në 47% të diskutimit. Shumica në 11% të diskutimit nuk i ka anashkaluar argumentet, por i ka shtrembëruar, ndërsa opozita ka bërë të njëjtën gjë në 13% të prezantimeve të tyre. Shumica injoroi argumentet e pjesëmarrësve të tjerë në 12% të diskutimit, ndërsa opozita injoroi argumentet e të tjerëve në 9% të fjalimeve të tyre.

Në 25% të diskutimit të pushtetit dhe në 41% të diskutimit të opozitës, nuk janë adresuar argumente apo pyetje nga folësit e tjerë të cilëve mund t'u përgjigjen ose t'u drejtohen, gjë që tregon përfshirje të ulët të shumicës në diskutim.

Në 25% të diskutimit të pushtetit dhe në 41% të diskutimit të opozitës, nuk janë adresuar argumente ose pyetje prej folësve të tjerë, në të cilat pyetje ose argumente mund të përgjigjeshin ose adresonin.

Grafiku 9. Përgjegjësia sipas përkatësisë politike (%)




■ FUQIA E ARGUMENTIT MË TË MIRË

Në këtë periudhë raportuese, **nuk është vërejtur ndryshim i pozicionit në diskutimet e monitoruara midis deputetëve, për shkak të argumenteve më të mira të bashkëbiseduesve ose ndonjë arsye tjetër**, e cila është në të njëjtin nivel me periudhën e fundit të vëzhgimit (korrik – dhjetor 2022). Në 50% të diskutimeve, nuk u vërejt asnjë referencë për cilësinë e argumenteve të deputetëve të tjerë, që është për 5 pikë të përqindjes më pak se periudha e mëparshme. Në 6% të diskutimeve të deputetët, nuk kishte ndryshim të qëndrimit për shkak se deputetët kishin të njëjtin qëndrim dhe pranuan vlerën e argumenteve të anëtarëve të partisë së tyre. Gjithashtu në 2% të diskutimit, deputetë nga opsione të ndryshme politike, megjithëse nuk e ndryshuan pozicionin e tyre, përsëri pranuan cilësinë dhe vlerën e argumenteve të bashkëbiseduesve të tyre nga partitë e tjera. Në 41% të diskutimit, deputetët mbajtën qëndrimin e tyre dhe nuk e pranuan vlerën e argumenteve të folësve nga opsionet e tjera politike. **Në përgjithësi, nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm drejt përmirësimit ose përkeqësimit në lidhje me këtë çështje në krahasim me periudhat e mëparshme të monitorimit.**

Në këtë periudhë raportuese, në diskutimet e monitoruara, nuk është vërejtur ndryshim qëndrimi te deputetët për shkak të argumenteve më të mira të bashkëbiseduesve apo për ndonjë arsye tjetër.

Grafiku 10. Fuqia e argumentit më të mirë të deputetëve (%)




Nëse sipas përkatësisë partiake të deputetëve, analizohet hapja ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë në seancat, mund të konkludohet se të dy palët ishin më të përqendruara në shprehjen e qëndrimeve të tyre. Në 39% të diskutimit të shumicës dhe 54% të opozitës, deputetët nuk folën në lidhje me argumentet e tjetrit.

Deputetët e pushtetit dhe opozitës nuk kanë ndryshuar qëndrim për asnjë çështje për shkak të bindjes ndaj argumenteve të bashkëbiseduesve të tyre.

Në diskutimet e shumicës, në 51% të rasteve nuk kishte ndryshim të qëndrimit dhe vlera e argumenteve të folësve nga opsioni tjetër nuk u pranua, e njëjta gjë ndodhi me diskutimet e opozitës (39%). Në 3% të diskutimit, shumica, edhe pse me qëndrim të ndryshëm, prapëseprapë e pranuan vlerën e argumenteve të tjetrit. Opozita veprroi në mënyrë të ngjashme në 2% të diskutimit të tyre. Deputetët e pushtetit (7%) dhe të opozitës (6%) janë pajtuar me qëndrimet e anëtarëve të partisë së tyre dhe kanë pranuar shprehimisht argumentet e tyre.

Deputetët e pushtetit dhe opozitës nuk kanë ndryshuar qëndrim për asnjë çështje për shkak të bindshëmrisë së argumenteve të bashkëbiseduesve të tyre.

Grafiku 11. Fuqia e argumentit më të mirë sipas përkatësisë politike (%)



■ RAPORTET E TRUPAVE TË PAVARURA DHE RREGULLATORE

Nga janari deri në qershor të vitit 2023 është vëzhguar shqyrtimi i 16 raporteve nga trupat e pavarura dhe rregullatore të dorëzuara në Kuvend. **Për tre raporte – “Raporti vjetor për punën e Komisionit për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021”, “ Raportet financiare të Agjencisë për Supervizion të Sigurimeve për vitin 2021” dhe “ Raporti vjetor për punën e Agjencisë për Supervizion të Sigurimeve për vitin 2021”, nuk u diskutua aspak në seancat plenare dhe në**

mbledhjet e komisioneve gjatë kësaj periudhe raportuese. Për raportet: “Raporti Vjetor për Zbatimin e Buxhetit Gjyqësor për vitin 2021”, “Raporti Vjetor për Punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022” dhe “Raporti Vjetor për punën e Agjencisë Operacionale dhe Teknike për vitin 2022”, diskutimi ishte dukshëm i shkurtër, dhe arriti në dy, gjegjësisht tre diskutues në total për secilin raport. Për 10 raportet e tjera nga organet e pavarura dhe rregullatore, deputetët zhvilluan një diskutim në komision dhe seanca plenare dhe raportet iu nënshtruan në një nivel të caktuar shqyrtimi.

Nga 16 raportet e monitoruara nga organe të pavarura dhe rregullatore, për 10 ka diskutim gjithëpërfshirës në Kuvend.

Këtë periudhë deputetët në përgjithësi u përfshinë në diskutimin aktiv dhe shqyrtimin e një numri më të madh të raporteve, për të cilat është jashtëzakonisht e rëndësishme të shqyrtohen në Kuvend, në mënyrë që të rritet transparenca mbi punën e pushtetit ekzekutiv, me çka qytetarët do të kenë këqyrje më të madhe në punën e trupave të pavarura dhe rregullatore.

Tabela 1. Raportet e trupave të pavarura dhe rregullatore

1	Raport vjetor për punën e Komisionit të Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021	10	Raport vjetor për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021-2025, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022
2	Raport financiar i Agjencisë për Supervizion të Sigurimit për vitin 2021	11	Raport vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Fushën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse për vitin 2022
3	Raport vjetor për funksionimin e Agjencisë për Supervizion të Sigurimeve për vitin 2021	12	Raport vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror për revizion për vitin 2021
4	Raport vjetor për Zbatimin e Buxhetit Gjyqësor për vitin 2021	13	Raport vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021
5	Raport vjetor për punën e Këshillit të prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022	14	Raport vjetor i Avokatit të Popullit mbi nivelin e sigurimit të respektit dhe avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në vitin 2022
6	Raport vjetor për veprimtari të Agjencisë Operative-Teknike për vitin 2021	15	Raport vjetor i Avokatit të Popullit mbi nivelin e sigurimit të respektit dhe avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në vitin 2021
7	Raport vjetor për punën e Këshillit të prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022	16	Raport vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë për vitin 2021
8	Raport vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2021		
9	Raport vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022		

■ Nuk ka diskutim

■ Diskutim i shkurtër

■ Ka diskutim



**RESPEKT, NDËRPRERJE
DHE KUFIZIME**



V. RESPEKT, NDËRPRERJE DHE KUFIZIME


■ RAPORTI NDAJ ARGUMENTEVE DHE PERSONALITETIT TË DEPUTETËVE NGA NJË PARTI TJETËR

Qëndrimi i folësve ndaj personit ose argumentet e folësit në anën e kundërt, mund të ndikojnë në atmosferën e përgjithshme të debatit. Domethënë, format e shprehura të mosrespektimit mund të ndryshojnë rrjedhën e diskutimit dhe fokusin e deputetëve nga argumentet drejt sulmeve dhe fyerjeve, duke polarizuar në mënyrë shtesë atmosferën dhe duke parandaluar debatin thelbësor. Atmosfera korrekte dhe respekti i ndërsjellë është një parakusht themelor për zhvillimin e një debati racional dhe të arsyetuar.

Në më shumë se dy të tretat e fjalimeve (71%), deputetët nuk marrin fare parasysht pretendimet dhe deklaratat e kolegëve të tyre.

Këtë periudhë, **respekti për argumentet shprehet vetëm në 2% të fjalimeve, përkatësisht në përputhje me periudhat e mëparshme të monitorimit.** Respekti i pjesshëm u shpreh në 6% të rasteve, që paraqet rënie të konsiderueshme prej 10 pikë të përqindjes krahasuar me periudhën korrik-dhjetor 2022 (16%). Në periudhën e monitorimit, mosrespektimi i pjesshëm i argumenteve të bashkëbiseduesve nga një parti tjetër politike është në të njëjtin nivel me periudhën e mëparshme, përkatësisht vërehet në 16% të diskutimit. **Mosrespektimi i argumenteve në periudhën janar-qershor 2023 është vërejtur në 4% të rasteve, përkatësisht krahasuar me periudhën korrik-dhjetor 2022 kur ka qenë i pranishëm në 6%, mbetet përgjithësisht pa zhvendosje të konsiderueshme. Megjithatë, shumica e argumenteve të bashkëbiseduesve (71%), mbeten të pa referuara nga kolegët e tyre.**


Grafiku 12. Qëndrimi ndaj argumenteve të deputetit të partisë tjetër (%)



Kur bëhet fjalë për qëndrimin e deputetëve ndaj personalitetit të kolegëve të tyre nga një parti tjetër politike, respekt është shprehur në 3% të diskutimit, që sugjeron për një rënie të konsiderueshme për dallim nga periudha e mëparshme e monitorimit, kur respekti është shprehur në 17% të rasteve. Respekti i pjesshëm u shpreh në 7% të diskutimit, që gjithashtu shënoi një rënie të konsiderueshme në krahasim me periudhën korrik-dhjetor 2022, kur respekti i pjesshëm ndodhi në 27% të fjalimeve të monitoruara. Mosrespektim i plotë u shpreh në 3% të diskutimeve, ndërsa mosrespektim i pjesshëm u shpreh në 9% të diskutimeve, gjë që mbetet relativisht i njëjtë me periudhat e mëparshme të monitorimit. Megjithatë, deputetët në 78% të diskutimit nuk iu referuan personalitetit të kolegëve të tyre të një provenience tjetër, që paraqet rritje të konsiderueshme prej 32 pikë të përqindjes krahasuar me periudhën e mëparshme (korrik - dhjetor 2022, 46%). Kjo përqindje sugjeron faktin se deputetët vendosën t' i referohen më pak personalitetit të bashkëbiseduesit.

Në 78% të fjalimeve të tyre, deputetët nuk i referohen aspak personalitetit të bashkëbiseduesit të tyre nga një parti tjetër politike. Kjo përqindje është më e larta në krahasim me tre periudhat e mëparshme raportuese, dhe do të thotë që deputetët kanë vendosur t' i referohen më pak personalitetit të bashkëbiseduesit.


Grafiku 13. Qëndrimi ndaj personalitetit të deputetit të partisë tjetër (%)



Në periudhën janar – qershor 2023, deputetët në mbi 70% të fjalimeve të tyre nuk trajtuan as argumentet e bashkëbiseduesit të një opsioni tjetër politik (71%) as personalitetin e tyre (78%). Kjo marrëdhënie ndryshon nga periudha e mëparshme e monitorimit (korrik-dhjetor 2022), kur argumentet e bashkëbiseduesve nuk u adresuan në 60% të fjalimeve, ndërsa personaliteti i tyre nuk u përmend në 46%. Përveç kësaj, mund të konkludohet se deputetët në pjesën tjetër të fjalimeve të tyre i referohen më pak karakteristikave personale të bashkëbiseduesve dhe më shumë një shqyrtimi substancial të argumenteve të tyre.

Në mbi 70% të fjalimeve, deputetët nuk i referuan as argumenteve të bashkëbiseduesve nga parti tjetër politike, as personalitetit të tyre. Megjithatë, në pjesën tjetër të fjalimeve, më tepër u referohen adresimit të argumenteve sesa karakteristikave personale.

Grafiku 14. Qëndrimi ndaj personalitetit dhe argumenteve të deputetëve të partive të tjera (%)




■ QËNDRIMI NDAJ ARGUMENTEVE DHE PERSONALITETIT SIPAS PËRKATËSISË POLITIKE TË DEPUTETËVE

Në raport me argumentet, në 2% të fjalimeve si të pushtetit ashtu edhe të opozitës, shprehet respekti, ndërsa respekti i pjesshëm shprehet në 9% të diskutimeve të pushtetit ose 3% të diskutimeve të opozitës. Në 37% të diskutimeve, pushteti ka shprehur mosrespektim ose mosrespektim të pjesshëm për argumentet e bashkëbiseduesve. Deputetët e shumicës nuk kishin referenca ndaj argumenteve të tjetrit në gjysmën e diskutimeve të monitoruara (52%). Opozita nuk kishte asnjë referencë për argumentet e tjetrit në 79% të diskutimeve, ndërsa në 15% të diskutimeve kanë shprehur mosrespektim të pjesshëm ose mosrespektim..

Krahasuar me kolegët e tyre nga opozita, deputetët nga pushteti në pjesën më të madhe të diskutimeve të tyre i referohen argumenteve të bashkëbiseduesve.


Grafiku 15. Qëndrimi ndaj argumenteve të tjetrit sipas përkatësisë politike (%)



Deputetët e pushtetit nuk kanë referencë për personalitetin e tjetrit në 72% të diskutimeve të tyre, ndërsa në 18% të rasteve është vërejtur mosrespektim i pjesshëm ose mosrespektim. Në 11% të diskutimeve është vërejtur respektim apo respektim i pjesshëm për personalitetin e bashkëbiseduesit. Në 81% të rasteve, deputetët e opozitës nuk kanë shprehur qëndrimin e tyre ndaj personalitetit të tjetrit. Në 11% të rasteve ata kanë shprehur mungesë respekti ose mosrespektim të pjesshëm, ndërsa në 7% të diskutimeve të monitoruara kanë shprehur respekt apo respekt të pjesshëm.

Deputetët e pushtetit në 11% të diskutimeve të tyre shprehën respekt ose respektim të pjesshëm ndaj personalitetit të kolegëve të tyre, ndërsa deputetët e opozitës e bënë këtë në 7% të diskutimeve të tyre.

Grafiku 16. Qëndrimi ndaj personalitetit të tjetrit sipas përkatësisë politike (%)




■ RAPORTI NDAJ ARGUMENTEVE DHE PERSONALITETIT SIPAS LLOJIT TË PJESËMARRËSVE NË DISKUTIM

Në 89% të diskutimit, deputetët e pushtetit nuk iu referuan fjalimit të pjesëmarrësve të jashtëm. Mosrespektimi i pjesshëm i argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm u vërejt vetëm në dy fjalime të deputetëve nga qeveria (0,5%), ndërsa në 11% të diskutimit kanë shprehur respekt të pjesshëm ose të plotë. **Deputetët e opozitës nuk kanë referencë në 82% të diskutimeve të tyre, ndërsa në 12% është vërejtur mosrespektim i pjesshëm ose mosrespektim i plotë.** Në 6% të rasteve është shprehur respekt i pjesshëm ose i plotë i anëtarit të jashtëm.

Në pjesën më të madhe të diskutimeve të tyre, deputetët e pushtetit dhe opozitës nuk iu referuan argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm.


Grafiku 17. Qëndrimi ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm sipas përkatësisë politike (%)



Deputetët e pushtetit në 91% të diskutimeve nuk kishin asnjë referencë për personalitetin e pjesëmarrësve të jashtëm, në 8% të rasteve ata kanë shprehur respekt ose respekt të pjesshëm, ndërsa në vetëm 3 fjalime (0,7%), kanë shprehur mosrespektim të pjesshëm. Nga ana tjetër, deputetët e opozitës nuk kanë shprehur qëndrimin e tyre ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm në 81% të diskutimeve. Në 4% të rasteve, opozita ka treguar respekt apo respekt të pjesshëm për personalitetin e pjesëmarrësve të jashtëm, ndërsa mosrespektim apo mosrespektim të pjesshëm ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm është shprehur në 15% të diskutimeve.

Deputetët nga pushteti në një përqindje më të madhe të fjalimeve të tyre nuk i referoheshin personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm (91%), krahasuar me kolegët e tyre deputetë nga opozita (81%).

Grafiku 18. Qëndrimi ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm (%)



Deputetët edhe në këtë, si në periudhat e mëparshme, **rrallë përdornin tregime, anekdota ose dëshmi në diskutimet e tyre. Elementë të tillë janë vërejtur në gjithsej 8% të diskutimeve.**

Në diskutimet, **pati një ndërprerje në 3 fjalimet e folësve (0,1%)** nga deputetët e tjerë. Këto janë ndërprerje që zgjasin deri në 10 sekonda, më shpesh të shkaktuara nga deputetë të cilët për momentin nuk kanë fjalë, dhe u hedhin fjalë nga vendi folësve.

Në 2% të diskutimeve, është vërejtur kufizim i folësit në shprehjen e folësit, shumica e të cilave ishte ndërhyrje pasive të folësit (1,6%). Në shumicën e fjalimeve (59%) e folësve, krahas fjalës së tyre kanë pasur edhe gjestikulime, ndërsa në 4% të diskutimeve vërehet përdorimi i rekuizitave në diskutim. Në 35% nuk ka gjestikulime eksplicite, ndërsa në 2% gjestikulimet u drejtohen të tjerëve.

Deputetët në përgjithësi janë të lirë dhe të pakufizuar në shprehjen e qëndrimeve të tyre në foltore.

VI.

GRUPET E MARGJINALIZUARA NË KUVEND



VI. GRUPET E MARGJINALIZUARA NË KUVEND

Gjatë monitorimit të cilësisë së debatit në Kuvend, kemi përfshirë në analizë grupet e marginalizuara dhe sa deputetët u referohen nevojave dhe të drejtave të grupeve të marginalizuara në fjalimet e tyre. **Në periudhën janar - qershor 2023, në 87,3% të fjalimeve të tyre, deputetët nuk folën në lidhje me të drejtat dhe nevojat e grupeve të marginalizuara. Është vërejtur se deputetët në pjesën më të madhe të fjalimeve të tyre nuk adresojnë të drejtat e grupeve të marginalizuara përveç nëse diskutohet specifikisht për ligj konkret ose temë në rend të ditës, në lidhje me të drejtat e tyre.** Duke pasur parasysh se shumica e ligjeve ndikojnë në mënyra të ndryshme mbi grupe të ndryshme të qytetarëve, kur shqyrtohen pikat e

Deputetët në pjesën më të madhe të fjalimeve të tyre nuk adresojnë të drejtat e grupeve të marginalizuara përveç nëse diskutohet specifikisht për ligj konkret ose temë në rend të ditës, në lidhje me të drejtat e tyre.

rendit të ditës, deputetët duhet të trajtojnë më shumë aspekte që mund të prekin qytetarët nga grupet e marginalizuara. Në diskutimet e monitoruara gjatë kësaj periudhe, **më të përfshirë në diskutim, megjithëse në një përqindje të vogël, janë të rinjtë (6.7%), gratë (1.6%) dhe romët (1.6%),** ndërsa prindërit e vetëm nuk u përfshinë fare, ndërsa komunitetet LGBTI+ u përfaqësuan në vetëm 2 fjalime. Megjithëse deputetët në përgjithësi rrallë u drejtohen të drejtave të grupeve të marginalizuara dhe komuniteteve, deputetët në masë të madhe u referohen këtyre komuniteteve për dallim nga kolegët e tyre deputetë.

Tabela 2.

Grupet e marginalizuara	Fjalime (%)	Fjalime (numër)
Prindër të vetëm	0	0
LGBTI +	0.1	2
Banorët e zonave rurale	0.3	6
Të moshuar	0.3	6
Të papunë	0.6	12
Personat me aftësi të kufizuara	1.1	24
Romë	1.6	35
Femra	1.6	35
Përdorues të ndihmës sociale	2	44
Tjetër	2.2	48
Të rinj	6.7	144
Asnjë referim për grupet e marginalizuara	87.3	1877

Tabela 3.

Grupet e marginalizuara	Fjalime (%)	Fjalime (numër)	Meshkuj (%)	Femra (%)
Prindër të vetëm	0	0	0	0
Komunitetit LGBTI+	0.1	2	0	100
Të moshuar	0.3	6	33	67
Banorët e zonave rurale	0.3	6	100	0
Të papunë	0.6	12	33	67
Personat me aftësi të kufizuara	1.1	24	29	71
Romë	1.6	35	46	54
Femra	1.6	35	17	83
Përdorues të ndihmës sociale	2	44	30	71
Tjetër	2.2	48	40	60
Të rinj	6.7	144	37	63
Nuk u referohen grupeve të marginalizuara	87.3	1877	60	40

VII.

DEMOGRAFIA E FOLËSVE




VII. DEMOGRAFIA E FOLËSVE

Struktura demografike e folësve, për nga përkatësia etnike, gjinore, arsimore dhe njësia zgjedhore e folësve mbetet përgjithësisht e njëjtë krahasuar me periudhën e mëparshme korrik - dhjetor 2022. Ajo që duhet theksuar është se edhe në këtë periudhë të monitorimit të debatit, pjesëmarrja e deputetëve nga komunitetet më të vogla (8%) ishte marginale në krahasim me deputetët etnik maqedonas (77%). Pjesëmarrja e grave në diskutim është në nivel të lartë 43%, dhe mbetet në një nivel relativisht të lartë, si dhe përfaqëson pjesëmarrjen më të lartë të grave në diskutim krahasuar me mandatet e monitoruara më parë. Deputetët më aktivë janë nga NjZ4 (23%) dhe NjZ3 (16%).

Pjesëmarrja e grave në diskutim është në një nivel të lartë prej 43% dhe mbetet relativisht në të njëjtin nivel me periudhën korrik - dhjetor 2022, që është pjesëmarrja më e lartë krahasuar me të gjitha periudhat e mëparshme të monitorimit.

Grafiku 19. Struktura demografike e folësve - deputetë (%)



IX.

REKOMANDIME



IX. REKOMANDIME

Kultura për debat e deputetëve të Kuvendin tonë, e mbështetur nga argumente të qarta dhe solide, me të cilat mbështet drejtpërdrejt pozicioni që ata përfaqësojnë, është në nivel relativisht të ulët. **Raportet e Institutit për Demokraci për cilësinë e debatit në përbërjen aktuale parlamentare (të zgjedhur në zgjedhjet e korrikut 2020), tregojnë se një numër dominues i diskutimeve që u zhvilluan në Kuvend janë përgjithësisht të argumentuar dobët.** Me fjalë të tjera, shumica e qëndrimeve që deputetët përfaqësuan në Kuvend, nuk janë të bazuara në prova dhe për këto qëndrime nuk janë ofruar arsytetime përkatëse. **Kjo situatë perceptohet në mënyrë objektive nga qytetarët, shumica e të cilëve vlerësuan nivelin e ulët të argumentimit në fjalimet e deputetëve, duke vlerësuar se deputetët rrallë ose kurrë nuk përdorin argumente në fjalimet e tyre.**¹⁵

Për këto arsye, është e nevojshme të rritet cilësia e debatit dhe niveli i argumentimit të fjalimeve të deputetëve në Kuvend. Ky raport mbi cilësinë e debatit në këtë pjesë përfshin disa rekomandime, por edhe mjete të disponueshme që janë në dispozicion të deputetëve për të arritur një nivel më të lartë të cilësisë së debatit.

Rritja e informimit dhe njohurive mbi temat që janë lëndë e diskutimit, si dhe përmirësim i aftësive debatuese dhe oratorike të deputetëve mund të kontribuojnë ndjeshëm për debat më të mirë në Kuvend. Instituti Parlamentar (IP) dhe Zyra parlamentare për buxhet (ZPB), të cilat funksionojnë në suazat e Kuvendit, ofrojnë shërbime që mund të adresojnë këto nevoja të deputetëve. Përkatësisht, IP dhe ZPB bëjnë hulumtime për tema me interes për deputetët, ndërsa IP ofron edhe edukim dhe trajnim në fusha të veçanta. Së këndejmi, paraqitet nevoja për përdorim më efikas dhe më efektiv të shërbimeve të IP-së dhe ZPB-së.

Kuvendi duhet të zbatojë në mënyrë aktive procesin e Vlerësimit të Ndikimit të Rregullativës (VNR), përmes së cilit do të rritet ndjeshëm cilësia dhe argumentimi i diskutimeve. VNR kontribuon në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes për rregullativat duke siguruar informacione mbi efektet dhe pasojat e masave të reja rregullatore, dhe bën vlerësimin dhe monitorimin e rregullativave ekzistuese. Ky mjet përdoret nga Qeveria, si propozuesi dominant i zgjidhjeve ligjore në vend, por jo edhe nga Kuvendi. Për këto arsye, Kuvendi është vendosur në rolin e vlerësuesit të propozimeve të Qeverisë, por është përgjithësisht jo konsistente në këtë rol, pasi argumentet e deputetëve nuk përqendrohen mjaftueshëm në përmbajtjen e rregullativave të propozuara ose diskutimi është argumentuar dobët.¹⁶ Së këndejmi, aplikimi i VNR në Kuvend dhe praktikimi

¹⁵ Vlerat mesatare për periudhën 2020 - 2021, të fituara nga raportet: "Rezultatet e anketës në terren për perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2020) IDSCS. «Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit» (2021) IDSCS.

¹⁶ Dimeski, Jane, «Debat- Analiza e Cilësisë së Diskutimit në Kuvend qershor 2014 - maj 2015», IDSCS, (2015), në dispozicion në <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2009/08/rovovska-debata-mk.pdf>

aktiv i VNR nga deputetët si propozues të zgjidhjeve ligjore, do të mundësojë diskutim më të argumentuar dhe miratim të vendimeve me informim të mirë.¹⁷ Në këtë drejtim, hulumtimi i Institutit Parlamentar (IP) dhe Zyrës Parlamentare të Buxhetit (ZPB) që vepron brenda Kuvendit mund të kontribuojë në gjithëpërfshirjen e procesit të VNR.

Deputetët duhet të përdorin me kujdes dhe në mënyrë minimale procedurën e shkurtuar dhe procedurën për rishikimin e propozim - ligjeve me flamurin Evropian. Procedura e shkurtuar dhe urgjente zvogëlon kohën për debat, ofron afate më të shkurtra për përfundimin e diskutimit, ndërsa në disa raste votohet edhe pa diskutim. Kufizimi i diskutimit në Kuvend parashikohet gjithashtu edhe për propozim - ligje për të cilat përdoret flamuri Evropian, i cili shënon harmonizimin e ligjit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.¹⁸ Praktika e përdorimit të procedurës me flamurin evropian është kritikuar edhe nga Delegacioni Evropian në Maqedoninë e Veriut.¹⁹ Keqpërdorimi i këtyre mekanizmave kufizon debatin midis deputetëve, ndikon negativisht në cilësinë e debatit, shkurtohet e drejta e deputetëve të diskutojnë dhe i privon nga miratimi i vendimeve me informim të mirë. Keqpërdorimi i tillë rezulton në mënyrë të pashmangshme në zgjidhje ligjore të nxituara dhe joadekuate. Në të njëjtën kohë, praktika të tilla kontribuojnë në një perceptim më negativ të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Është thelbësore që deputetët të mbindërtohen me profesionalizëm dhe të kuptojnë për ndikimin e ligjeve mbi jetën e grupeve të ndryshme qytetarësh. Pjesërisht, këtë mund ta arrijnë me përdorimin e analizave të Institutit Parlamentar dhe Zyrës Buxhetore Parlamentare (ZBP). Në mënyrë plotësuese, gjithashtu duhet t'i kërkojnë VNR Raportet të përgatitura nga Qeveria dhe të konsultohen me shërbimet parlamentare me përvojë, qytetarë dhe sektorin joqeveritar mbi ndikimin e ligjeve. Gjatë debatit vlerë të shtuar paraqet përdorimi i *shembujve* nga përvoja, shqetësimet ose interesat e votuesve (zyra për komunikim me qytetarët, histori personale, storje mediatike, biznese lokale), si dhe reagimi dhe ballafaqimi përkatës ndaj *vërejtjeve* ose *fjalimeve* seksiste apo diskriminuese në Kuvend. Në këtë drejtim, vlera e shtuar do të ishte përdorimi i mekanizmit për seanca legjislative publike të rregulluara me Rregulloren e punës së Kuvendit, ku komisionet amë mund të organizojnë seanca publike në lidhje me ndonjë propozim-ligj.

¹⁷ Bliznakovski, Jovan «Praktikat e mira krahasuese për zbatimin e VNR dhe mundësi për zbatimin e tyre në Maqedoni», IDSCS, (2017), në dispozicion në: <<https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/>>

¹⁸ Dimitrievski, Dejan «Miratimi i ligjit me procedurë të shkurtuar ose urgjente» Instituti Parlamentar, (2017) në dispozicion në: <<https://www.sobranie.mk/content/PI/>>

¹⁹ Meta (2023). Gere: Shqetësimet në lidhje me përdorimin e flamurit evropian janë kur nuk ka harmonizim me rregullativën evropiane. Qasur në: <https://meta.mk/gir-zagrizenosta-za-koristenjeto-evropsko-znamence-e-koga-nema-usoglasuvanje-so-evropskata-regulativa/>

Deputetët, përveç ekspertizës së IP dhe ZBP, kanë në dispozicion disa mjete për të forcuar kapacitetin e tyre për shqyrtimin dhe debatimin në lidhje me ligjet, përfshirë trajnimet që i ofron Programi për Mbështetje Parlamentare (PSP), mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunimi (SDC). Ky program deputetëve u ofron trajnime për analizën e politikave dhe harmonizimin me legjislacionin e BE-së, trajnim mbi analizën e ndikimit të ligjeve (AVL), ndikimin mbi barazinë gjinore dhe implikimet buxhetore të ligjeve, simulimet për VNR për shërbimin parlamentar dhe kanalën e Kuvendit, mbështetjen e Kuvendit për përfshirjen e VNR-së mbi ligjet e propozuara, si dhe forcimin e njohurive dhe aftësive për debat të argumentuar, përfshirë aftësitë për të folur në publik dhe bashkëpunim me mediat.

Së fundi, është e nevojshme të ketë kalendar të seancave sipas shembullit të parlamenteve të vendeve të Evropës Perëndimore. Kalendar i seancave do të sigurojë parashikueshmëri të punës së Kuvendit si dhe më shumë kohë për deputetët, për përgatitje për pikat e rendit të ditës. Me kohën në dispozicion dhe parashikueshmërinë më të madhe, deputetët do të mund të informohen me kohë për propozim-ligjet, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve, raportet e trupave rregullatore dhe të pavarura dhe aktet tjera në Kuvend. Parashikueshmëria e seancave do të kontribuojë për diskutim më cilësor dhe më të argumentuar.

X. SHTOJCA 1 - INDEKSI I CILËSISË SË DEBATIT

Indeksi i cilësisë së debatit është indeks i përbërë i përbërë nga disa tregues që rezultojnë nga monitorimi i debatit. Indeksi ndodh në disa faza ku faza e fundit është shuma e vlerave të ponderuara të treguesve individualë. Indeksi përfshin:

Tabela 1.

Emri	Shkalla	Pjesëmarrja në shumën përfundimtare (%)
Shkalla e arsytimit	[-1:1]	20
Përfshirja e arsytimit	[-1:1]	5
Përgjegjësi	[-1:1]	20
Fuqia e argumentit më të mirë	[-1:1]	20
Qëndrimi ndaj pjesëmarrësve të partie tjetër	[-1:1]	10
Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të partisë tjetër	[-1:1]	10
Raporti ndaj pjesëmarrësve të jashtëm	[-1:1]	2,5
Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm	[-1:1]	2,5
Ndërprerje	[-1:1]	5
Kufizim	[-1:1]	5

Për qëllime të indeksimit, secilit prej indikatorëve iu caktuan rezultatet për kategoritë individuale. Vlerësimet janë dhënë në tabelën vijuese:

Tabela 2.

Shkalla e arsytimit	notat	Përfshirja e arsytimit	notat
më shumë se 2 argumente	4	parime abstrakte	2
2 argumente	3	e mirë e përgjithshme	2
1 argument	2	grupe të tjera	1
dobët	0	grup vetanak	1
nuk ka	-2	neutrale	0

Përgjegjësi	notat	Fuqia e argumentit më të mirë	notat
adreson argumente në mënyrë të përshtatshme	2	ndryshim për shkak të argumenteve	5
pjesërisht i injoron, shtrembëron, adreson argumentet	1	asnjë ndryshim, me pozicion të ndryshëm, pranon argumente	3
nuk u adresuan argumente nga folës tjetër	0	asnjë ndryshim, qëndron në pozicionin e vet, pranon argumentet	1
injoron argumentet	-1	asnjë ndryshim, nuk pranon argumente	0
nuk injoron arg. por i shtrembëron	-2	ndryshim por jo për shkak të argumenteve	0
		asnjë referencë	0

Qëndrimi ndaj pjesëmarrësve të partie tjetër	notat	Raporti ndaj pjesëmarrësve të jashtëm	notat
respektim eksplisit	2	respektim eksplisit	2
respektim	2	respektim	2
respektim i pjesshëm	1	respektim i pjesshëm	1
asnjë referencë	0	asnjë referencë	0
mosrespektim i pjesshëm	-1	mosrespektim i pjesshëm	-1
mosrespektim	-2	mosrespektim	-2

Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të partisë tjetër	notat	Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm	notat
respektim eksplisit	2	respektim eksplisit	2
respektim	2	respektim	2
respektim i pjesshëm	1	respektim i pjesshëm	1
asnjë referencë	0	asnjë referencë	0
mosrespektim i pjesshëm	-1	mosrespektim i pjesshëm	-1
mosrespektim	-2	mosrespektim	-2

Kufizim	notat	Ndërprerje	notat
nuk ka	0	nuk ka ndërprerje	0
ka pengim pasiv	-1	ka ndërprerje	-1
ka folësi sugjeron se është penguar	-1		
ka ndërprerje fizike	-2		

Secili nga këta indikatorë u shndërrua në mënyrë lineare në nën-indekse në shkallë prej -1 në 1, duke mbajtur llogari gjatë transformimit që nota origjinale të mos humbte shenjën pozitive ose negative. Prandaj, formula universale e transformimit është:

$$i = \frac{2 \times \text{indicator}}{(\text{max} - (-\text{max}))}$$

për të gjithë indikatorët përveç ndërprerjes dhe kufizimit sepse në këta dy indikatorë vlera absolute e notës më të ulët të mundshme është më e madhe se vlera e notës më të lartë të mundshme. Prandaj formula është:

$$i = \frac{2 \times \text{indicator}}{(|\text{min}| - (\text{min}))}$$

Pas llogaritjes së nën-indekseve të indikatorëve individualë, për llogaritje do të kalkulohet shuma preDQI me vlerat e ponderuara të nën-indekseve sipas pjesëmarrjes së dhënë në Tabelën 1.

Për analizë më të lehtë, DQI përfundimtar transformohet në mënyrë lineare në shkallën nga 1 në 10 sipas formulës në vijim:

$$DQI = \frac{(10 - 1)}{(1 - (-1)) \times (\text{preDQI} - 1) + 10}$$

Këto llogaritje dhe transformime bëhen për secilin fjalim individualisht dhe raporti përcjell mesataren aritmetike të të gjitha fjalimeve nga periudha e monitoruar.

INFORMACIONE RRETH PROJEKTIT

Programi Zviceran për Mbështetje Parlamentare (PMP) do të mbështesë përpjekjet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për pavarësi përmes ndërtimit të konsensusit, reformave strukturore dhe ndërtimit të kapaciteteve në zhvillimin institucional të Kuvendit; në rolet e tij legislative dhe mbikëqyrëse dhe në transparencën dhe llogaridhënien e tij institucionale. PSP-ja, zbatohet nga Instituti Demokratik Nacional, Instituti për Demokraci «Societas Civilis» - Shkup dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime, për mbështetjen e planifikimit strategjik të Kuvendit; për reforma në menaxhimin me burimet njerëzore; për vlerësimin e përmirësuar të ndikimit të rregullativës dhe proceset e prokurimit; për përkushtim ndaj të dhënave të hapura dhe përmes matjes së opinionin publik dhe monitorimit të përpjekjeve për reformë, përfshirë edhe për angazhimin më të madh qytetar në proceset e krijimit të politikave.

INFORMACIONE RRETH IDSCS-Ë

Instituti për Demokraci «Societas Civilis» Shkup (IDSCS) është një organizatë think tank që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut. IDSCS ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën participative politike. Përmes forcimit të vlerave liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën e diversiteteve.

IDSCS, që nga qershori 2014, monitoron cilësinë e debatit në Kuvend dhe mbulimin mediatik të punës së Kuvendit. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua për 10 muaj, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015. Nga shtatori i vitit 2015 vijoi periudha e dytë e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së debatit parlamentar dhe mbulimit mediatik, mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që zgjati deri në dhjetor të vitit 2017. Periudha e tretë e monitorimit të cilësisë së debatit filloi në janar të vitit 2018 dhe zgjati deri në dhjetor të vitit 2019. **Që nga janari 2020, Instituti për Demokraci monitoron punën e Kuvendit dhe cilësinë e debatit në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP).**

Të dhëna për kontakt - IDSCS

Adresa: rr. Miroslav Krlezha nr. 52/1 /2,
1000 Shkup
Tel. nr. / Faks: +389 2 3094 760,
posta elektronike: contact@idscs.org.mk

